



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 17  
Prishtinë, 22 korrik 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Bujar Bukoshi, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Mungoi: Slllobodan Petrovic.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj-administratore, Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta- nëpunëse administrative.

Nga NDI: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar ;
3. Monitorimi i Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryetari i Komisionit - Konstatoi se procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.*

## 3. Monitorimi i Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi

**Kryetari i Komisionit** – Meqë grupi punues i Komisionit ka pasur një vizitë në MSH, nga ky grup kërkoi një informatë me qëllim që Komisioni të njoftohet për së afërmi lidhur me këtë vizitë në mënyrë që pastaj Komisioni të hartoi një raport me rekomandime lidhur me monitorimin e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi.

**Qamile Morina** – Kryesuese e grupit punues – në kuadër të objektivave, që ky grup ka marrë nga Komisioni, ne kemi pasur takim me zyrën ligjore të MSH – së, Bordin për licencime dhe Inspektoratin shëndetësor.

- Informata e saj për zyrën ligjore ishte, se zyra ligjore nga 8 akte nënligjore që ka qenë e obliguar ti nxjerr sipas ligjit, i ka nxjerrë 5 prej tyre;
- Zyra ligjore nuk ka ndonjë plan se kur do të nxirren edhe aktet tjera nënligjor;
- Ka paqartësi lidhur me të hyrat që Ministria i fiton nga licencimet, të cilat të hyra sipas ligjit janë të hyra vetanake dhe të cilat janë të rregulluara me memorandum e që ato sjellin probleme financiare;
- Paqartësi tjetër ishte edhe mbyllja e zyrave komunale me arsyetimin e Ministrisë se mbyllja e tyre ishte bërë për shkak të mungesës financiare. Pas mbylljes së zyrave komunale, bordi bënë vizita, bordi vendos dhe me marrjen e përgjegjësive të reja, sipas saj, bordi në fjalë bie në konflikt interesi;
- Sa i përket Inspektoratit shëndetësor mbikëqyrja konform nenit 26 të Ligjit në fjalë nuk bëhet ngase ky organ nuk ka plan pune, ndërsa roli mbikëqyrës i inspektorit shëndetësor është i limitizuar për këto arsye: mungesa e stafit, pamjaftueshmëria logjistike me sqarimin se në ditët dhe kohët e caktuara, kur ordinancat private punojnë, ai nuk mund të shkojë ti inspektojë.
- Numri i ordinancave të licencuara është në diskrepancë me web – faqen e Ministrisë.

**Mimoza Ahmetaj** – Anëtare e grupit punues, për të plotësuar diskutimin e znj. Qamile Morina e informoi Komisionin se MSH – ja përveç mungesës së buxhetit ka kërkuar komunikim të drejtpërdrejt me qendrat e mjekësisë në regjion pa ndonjë organ ndërmjetësues me qëllim të korrespondimit më të lehtë dhe të drejtpërdrejt.

**Teuta Hadri** – Propozoi, që kur komisioni do ta hartojë raportin nga këto vizita në fjalë, një raport i tillë të jetë sipas qëndrimit të gjithë komisionit, sepse qëllimi i monitorimit është që komisioni të informohet me të metat gjatë licencimit duke mos mohuar edhe anët pozitive të licencimeve.

**Armend Zemaj** – Propozoi që pas vizitave të grupit punues të hartohet një raport preciz nga i cili do të nxirren rekomandimet e komisionit.

**Kryetari i Komisionit** – Kërkoi nga anëtarët e komisionit që ti japin propozimet e veta në mënyrë që nga monitorimi i ligjit në fjalë të nxirren rekomandimet nga vet propozimet e komisionit. Ai

propozoi, që në shtator të vendoset për një dëgjim publik lidhur me monitorimin apo të ftohet ministri në mbledhje të komisionit.

**Gjynaze Syla** – Propozoi, që nga monitorimi i ligjit të hartohet raporti me rekomandime për Kuvendin e Kosovës.

**Flora Brovina** – Tha se, grupi punues për monitorimin e ligjit është dashur të udhëhiqet nga vet kryesuesi i komisionit, ngase në cilësinë e kryesuesit, ai duhet ti prijë proceseve duke përfshirë edhe monitorimin në fjalë për aq më tepër se vet kryesuesi i komisionit ka qenë, në atë kohë, nënshkrues i ligjit dhe i nënshkrimit të akteve nënligjore.

**Kryetari i Komisionit** – Tha se komisioni ka vendosur që kryesues i grupit për monitorimin e ligjit të jetë një anëtar nga radhët e opozitës dhe kishte propozuar, që ai vet, të mos jetë anëtar i grupit punues me qëllim që ti shmanget subjektivitetit dhe për të mbajtur neutralitetin.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se grupi punues duhet të ketë plan konkret të punës dhe pas çdo vizite duhet të hartojë një draft raport .

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, grupi punues e njoftoi komisionin se vizita e radhës do të jetë në një apo dy ordianca private.

#### **4. Të ndryshme**

**Kryetari i Komisionit** – Njoftoi anëtarët e komisionit se P/ligji për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara është shtyrë për shqyrtim të dytë, për arsye se Komisioni për Buxhet ka konstatuar se P/ligji në fjalë ka implikime buxhetore, me gjithë shkresën që komisioni i ka dërguar sponzoruesit për të kërkuar sqarime. Meqë deri tani komisioni nuk ka marrë përgjigje, propozoi që komisioni t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit për tu informuar se si do të veprohet më tutje pasi që Komisioni ka përfunduar punën me shqyrtimin dhe hartimin e amendamenteve. Lidhur me këtë Komisioni vendosi unanimitisht që Kryesisë së Kuvendit ti drejtohet me këtë:

### **REKOMANDIM**

**Te kërkoj nga Qeveria e Kosovës përgjigje lidhur me implikimet buxhetore të Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

#### **Arsyetim**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision përgjegjës raportues për Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara ka hartuar raportin me amendamente dhe ja ka dërguar komisioneve Kryesore , Komisionit për Buxhet e Financa dhe Komisionit për të drejtat dhe interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Me 16.05.2008 Komisioni ka pranuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa një raport me rekomandime ku thuhet që Projektligji bashkë me amendamentet e propozuar ka implikime buxhetore . Komisioni ne shkresën e datës 27 maj 2008 kërkoj nga kryeministri i Republikës se Kosovës përgjigje lidhur implikimet buxhetore për këtë projektligj . Deri me tani Komisioni nuk ka marr asnjë përgjigje nga Qeveria. Komisioni kërkon nga kryesia që edhe një herë te kërkohet nga Qeveria një përgjigje lidhur

me këtë P/Ligj pas komision ka kaluar te gjitha afatet për procedim dhe nuk mund te bej asgjë pa propozimet konkrete te Qeveris lidhur me implikimet buxhetore.

**Armend Zemaj** – Kërkoj që Komisioni ta vizitojë Këshillin grevist të RTP-së, pasi që ata kishin hyrë në ditën e 13 të grevës.

Komisioni formoi një grup prej tre anëtarëve për të vizituar grevistët.

**Gjynaze Sylja** – Njoftoi komisionin për kërkesën e drejtorit të Trustit Pensional për një takim me komisionin me qëllim të informimit të komisionit për Trustin Pensional.

**Teuta Hadri** – Pati dy vërejtje: kërkoj sqarime lidhur me nxjerrjen e konkluzionit për vizitën në institucionin e Shtimes dhe lidhur me një vizitë jashtë vendit për P/ligjin për Punën.

**Bujar Bukoshi** – Tha se, Komisioni duhet të profilohet se për çka do të bëjë vizitë, të ketë konceptim të funksionimit të komisionit.

**Flora Brovina** – Njoftoi komisionin për një takim që kanë pasur gratë deputete me një delegacion të regjionit, të Maqedonisë e Shqipërisë, ku është diskutuar për disa ligje të cilat janë jetike, të rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe për të cilat FMN-ja po bënë obstrukcione.

Ne duhet ti marrim praktikat e vendeve që kanë kaluar në këtë fazë në të cilën jemi ne, sidomos për P/ligjin për Punën - pushimi i lehonisë. Në këto vende pushimi i lehonisë është një vit, ndërsa ne për këtë kemi kërkuar 6 muaj dhe nuk guxojmë të lejojmë që ky pushim në vendin tonë të jetë 3 muaj, ngase ky do të ishte një diskriminim i nënës ndaj fëmijut.

**Kryetari i Komisionit** – Tha se për këto probleme, ne si komision, mund të marrim vetëm qëndrim, ngase këto probleme duhet të lobohen në Parlament, meqë problemet për këto ligje kaheerë inicohen në Parlament.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

*Përgatitur nga*

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

*Sadik Idriz*